

URDHËR
Nr. 166, datë 27.4.2022

**PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE KARAKTERISTIKAT E TJERA TË VULËS
DHE RREGULLAT PËR PAJISJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE, SI DHE
FORMËN E KARTËS SË IDENTIFIKIMIT TË PËRKTHYESIT ZYRTAR DHE
INTERPRETIT TË GJUHËS SË SHENJAVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së vulës të përkthyesit zyrtar, sipas modelit në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e formës së kartës së identifikimit të përkthyesit zyrtar dhe të interpretit të gjuhës së shenjave sipas përshkrimeve në shtojcat nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Çdo përkthyes zyrtar, përpara fillimit të ushtrimit të profesionit pajiset me vulë dhe me kartën e identifikimit të përkthyesit, shpenzimet e të cilave përballohen prej tij. Çdo interpret i gjuhës së shenjave, përpara fillimit të ushtrimit të profesionit, pajiset me kartën e identifikimit, shpenzimet e të cilës përballohen prej tij.

4. Karta e identifikimit përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj dhe paraqitet në çdo rast të ushtrimit të detyrës nga përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave, kur caktohen nga autoritetet publike ose organet proceduese, pa qenë i pajisur me kartën e identifikimit.

5. Prodhimi i vulës bëhet nga subjekte shtetërore të specializuara dhe kur kjo nuk është e mundur nga subjekte private shqiptare ose të huaja, që e ushtrojnë veprimtarinë e përgatitjes së vulave me leje të lëshuar nga organet kompetente. Karta e identifikimit mund të prodhohet nga subjektet private, sipas përshkrimeve të përcaktuara në shtojcat 2 dhe 3, vetëm kur përmbushen rregullat e përcaktuara në këtë urdhër.

6. Ministria e Drejtësisë, me kërkesë të përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave, porosit dhe shpërndan vulën dhe kartën e identifikimit.

7. Përkthyesi zyrtar mund të paraqesë kërkesën për t’u pajisur me vulë dhe kartë identifikimi, në rastet kur ka marrë certifikatën për ushtrimin e profesionit për herë të parë, ose në çdo rast tjetër, kur provohet që vula ose karta e identifikimit ka humbur ose është dëmtuar. Interpreti i gjuhës së shenjave mund të paraqesë kërkesën për t’u pajisur me kartë identifikimi, në rastet kur ka marrë certifikatën për ushtrimin e profesionit për herë të parë, ose në çdo rast tjetër, kur provohet që karta e identifikimit ka humbur ose është dëmtuar. Kërkesa për t’u pajisur me vulë ose me kartë identifikimi paraqitet me shkrim, së bashku me të dhënat e nevojshme për prodhimin e vulës ose të kartës së identifikimit.

8. Tarifa për pajisjen me vulë dhe kartën e identifikimit, që mbulon koston e prodhimit të tyre, i paguhet subjektit të përcaktuar në pikën 5, të këtij urdhri, nga përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave, pas miratimit nga Ministria e Drejtësisë për prodhimin e vulës ose të kartës së identifikimit.

9. Pas prodhimit, vula ose karta e identifikimit merret në dorëzim nga personi i ngarkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, i cili mban një procesverbal për marrjen e saj.

10. Ministria e Drejtësisë njofton me shkrim ose me mjete elektronike përkthyesin zyrtar për ditën dhe orën për dorëzimin e vulës ose kartës së identifikimit, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para

datës së caktuar për dorëzimin e saj. Nëse përkthyesi zyrtar nuk mund të paraqitet për pajisjen me vulë, procesi i dorëzimit zhvillohet një ditë tjetër.

11. Dorëzimi i vulës ose i kartës së identifikimit përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave kryhet në mjediset e Ministrisë së Drejtësisë nga personi i ngarkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.

12. Për dorëzimin e vulës ose kartës së identifikimit mbahet një procesverbal, i cili nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, personi i ngarkuar nga Sekretari i Përgjithshëm për dorëzimin e vulës ose kartës së identifikimit dhe nga përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave. Procesverbali pasqyron kohën, vendin, emrin e pjesëmarrësve dhe faktin e marrjes së vulës në dorëzim nga përkthyesi zyrtar. Procesverbali nënshkruhet nga personat e sipërpërmendur. Një kopje e procesverbalit i jepet përkthyesit zyrtar dhe një kopje depozitohet pranë Ministrisë së Drejtësisë.

13. Përkthyesi zyrtar është i detyruar të kujdeset për ruajtjen e vulës nga dëmtimet, vjedhjet dhe përdorimin nga të tretët.

14. Vula është personale dhe përdoret vetëm nga përkthyesi zyrtar. E drejta për të përdorur vulën nuk mund t'i jepet në asnjë rrethanë të tretëve. Përdorimi i vulës ose i kartës së identifikimit nga persona të tretë, kur nuk përbën vepër penale, përbën shkelje disiplinore.

15. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave i pezulluar, dorëzon kartën e identifikimit dhe, kur është rasti, vulën, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, brenda pesë ditëve nga marrja e njoftimit të urdhrit përkatës.

16. Vula dhe karta e identifikimit arkivohen në dosjen personale të përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhëve të shenjave pranë Ministrisë së Drejtësisë me shënimin përkatës dhe i kthehet përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhëve të shenjave vetëm pas rifillimit të ushtrimit të profesionit, sipas legjislacionit në fuqi.

17. Procesi i dorëzimit, arkivimit apo përkatësisht rikthimit të vulës dhe kartës së identifikimit, pasqyrohet në procesverbalin përkatës që mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë.

18. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, përkthyesit zyrtar dhe interpretët e gjuhës së shenjave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

19. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCË NR. 1 FORMA DHE PËRMBAJTJA E VULËS SË PËRKTHYESIT ZYRTAR

Vula e përkthyesit zyrtar ka ngjyrë blu dhe formë rrethore me diametër 35 mm. Brenda saj janë shkruar në formë të harkuar me shkronja të mëdha fjalët “REPUBLIKA E SHQIPËRISË”. Poshtë tyre me shkronja të mëdha, por më të vogla si madhësi, në një rresht të dytë në formë të harkuar vendoset emri, shkronja e parë e emrit të babait dhe mbiemri i përkthyesit zyrtar. Në qendër vendoset stema e Republikës së Shqipërisë dhe poshtë saj në formë të harkuar në të kundërt të emrit dhe mbiemrit të përkthyesit zyrtar është shkruar me shkronja të mëdha, dhe të njëjtës madhësi me fjalët “Republika e Shqipërisë”, fjala “PËRKTHYES ZYRTAR”.



SHTOJCË NR. 2

PËRSHKRIMI I KARTËS SË IDENTIFIKIMIT PËR PËRKTHYESIT ZYRTAR

1. Karta e identifikimit e përkthyesit zyrtar ka ngjyrë të bardhë, formë drejtkëndore me lartësi 86.0 mm dhe gjerësi 54.0 mm. Korniza e kartës së identifikimit ka ngjyrë të kuqe, ndërsa korniza e vendit ku do të vendoset fotografia ka ngjyrë të kuqe të lehtë. Materiali i kartës së identifikimit është plastik, polikarbonat, me jo më pak se 4 (katër) shtresa. Në pjesën e sipërme të kartës vendoset stema e Republikës së Shqipërisë, dhe poshtë saj, emërtimi Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë.

2. Të dhënat që janë në përmbajtje të kartës së identifikimit janë si më poshtë:

- a) emri;
- b) mbiemri;
- c) gjuha për të cilën është certifikuar;
- ç) adresa;
- d) numër kontakti;
- dh) data e lëshimit;
- e) numri i certifikatës;
- f) fotografia e përkthyesit zyrtar.

SHTOJCË NR. 3

PËRSHKRIMI I KARTËS SË IDENTIFIKIMIT PËR INTERPRETIN E GJUHËS SË SHENJAVE

1. Karta e identifikimit e interpretit të gjuhës së shenjave ka ngjyrë të bardhë, formë drejtkëndore me lartësi 86.0 mm dhe gjerësi 54.0 mm. Korniza e kartës së identifikimit ka ngjyrë blu, ndërsa korniza e vendit ku do të vendoset fotografia ka ngjyrë blu të lehtë. Materiali i kartës së identifikimit është plastik, polikarbonat, me jo më pak se 4 (katër) shtresa. Në pjesën e sipërme të kartës vendoset stema e Republikës së Shqipërisë, dhe poshtë saj, emërtimi Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë.

2. Të dhënat që janë në përmbajtje të kartës së identifikimit janë si më poshtë:

- a) emri;
- b) mbiemri;
- c) adresa;
- ç) numër kontakti;
- d) data e lëshimit;
- dh) numri i certifikatës;
- e) fotografia e interpretit të gjuhës së shenjave.